



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

Nr. 2718 / Prot.

2

Vlorë më, 21.11.2024

**VENDIM**  
Nr. 72, datë 20.11.2024

**PËR**  
**MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN "PËR ZGJEDHJEN E**  
**KËSHILLAVE STUDENTORË" NË UV**

Në mbështetje të nenit 38, pika 1, shkronja d, të Ligjit nr. 80/ 2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenit 19, pika 1, gërma dh, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, si dhe referuar propozimit të Sektorit Juridik ardhur me shkresën nr.2613 prot, datë 18.11.2024, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 20.11.2024,


**VENDOSI:**



1. Të miratojë ndryshimet në Rregulloren "Për Zgjedhjen e Këshillave Studentorë" sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.
2. Shfuqizohet cdo vendim që bie në kundërshtim me këtë Rregullore.
3. Vendimi protokollohet dhe shpallet në faqen WEB të UV-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**

**Prof. Dr. Aurela Saliq**







REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
SENATI AKADEMIK

## RREGULLORE

PËR ZGJEDHJEN E KËSHILLAVE STUDENTORË  
NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORË

VLORË, NENTOR 2024





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
SENATI AKADEMIK

## KREU I

### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### Neni 1

#### Objekti i rregullores

Kjo rregullore përcakton rregullat për përgatitjen, organizimin, zhvillimin, administrimin, mbikëqyrjen dhe shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve për Këshillat Studentore në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, duke përfshirë:

- kushtet dhe afatet për regjistrimin e kandidatëve, të drejtat dhe detyrimet e tyre;
- dokumentacionin zgjedhor, listat e zgjedhësve, fushatat zgjedhore;
- rregullat për organizimin dhe funksionimin e administratës zgjedhore;
- kriteret për hartimin e listës së zgjedhësve;
- procedurat për votimin, vlerësimin dhe numërimin e votave, shpalljen e rezultateve;
- procedurat për shqyrtimin e ankimimeve;

#### Neni 2


#### Baza ligjore

Kjo rregullore mbështetet në nenin 99 të ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenin 74 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.

#### Neni 3

#### Subjekti i rregullores

1. Subjekt i kësaj rregulloreje janë, Këshilli Studentor i cili vepron në nivel institucional dhe Këshillat studentor të cilët veprojnë në nivel njësie kryesore.
2. Subjekt i kësaj rregullore janë studentët që studiojnë në të gjitha programet e studimit të ofruara nga Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë, në ciklin e parë, në ciklin e dytë dhe në ciklin e tretë të studimeve si dhe studentët të cilën ndjekin programe studimi dyvjeçare.
3. Çdo student ka të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur përfaqësues i studentëve në këshillat studentor që do të formohen në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.
4. Këshillat studentore nuk mund të organizohen me struktura të tjera politike e jopolitike, jashtë Universitetit.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
SENATI AKADEMIK

**Neni 4**  
**Parimet e përgjithshme**

1. Zgjedhjet për Këshillat Studentorë të Fakulteteve të UV-së si dhe Këshilli Studentor të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë zgjidhen në mënyrë periodike çdo 2(dy) vjet nga votat e studenteve.
2. Në rastet kur një individ i zgjedhur në këshillat e studentëve përfundon studimet universitare, ai zëvendësohet nga kandidati pasardhës në renditje për nga numri i votave të grumbulluara në zgjedhjet e fundit, deri në përfundim të mandatit të nisur.
3. Këshilli Studentor i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë (KSUIQV) përbëhet në total nga 13 (trembëdhjetë) student. Çdo fakultet do të ketë nga 3 (tre) përfaqësues 2 (dy) nga programi Bachelor dhe profesional, 1 (një) përfaqësues nga programi Master, 1 (një) përfaqësues do të jetë nga programi Doktoraturës. Këshilli Studentor në nivel institucional zgjidhet nga asambleja e studenteve të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë. Për Këshillin Studentor në nivel institucional votojnë studentët e të gjitha programeve të studimit, në të gjitha ciklet e studimit.
4. Këshilli Studentor i Fakultetit të Shkencave Humane përbëhet nga 9 (nëntë) anëtarë përfaqësues të studentëve:
  - 3(tre) anëtarë zgjidhen nga studentet e Departamentit të Drejtësisë;
  - 3(tre) anëtarë zgjidhen nga studentet e Departamentit të Edukimit;
  - 1(një) anëtarë zgjidhet nga studentët e Departamentit të Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë;
  - 2(dy) anëtarë zgjidhen nga studentët e Departamentit të Gjuhëve të Huaja.
5. Këshilli Studentor i Fakultetit të Ekonomisë përbëhet nga 9 (nëntë) anëtarë përfaqësues të studentëve:
  - 3(tre) anëtarë zgjidhen nga studentët e Departamentit të Biznesit;
  - 3(tre) anëtarë zgjidhen nga studentët e Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit;
  - 3(tre) anëtarë zgjidhen nga studentët e Departamentit të Ekonomiksit;
6. Këshilli Studentor i Fakultetit të Shëndetit përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë përfaqësues të studentëve:
  - 4(katër) anëtarë zgjidhen nga studentët e Departamentit të Infermierisë;
  - 3(tre) anëtarë zgjidhen nga studentët e Departamentit të Kujdesit Shëndetsor;
7. Këshilli Studentor i Fakultetit të Shkencave Teknike përbëhet nga 9 (nëntë) anëtarë përfaqësues të studentëve:
  - 2(dy) anëtarë zgjidhen nga studentët e Departamentit të Shkencave Kompjuterike;
  - 2(dy) anëtarë zgjidhen nga studentët e Departamentit të Biologjisë;
  - 1(një) anëtar zgjidhet nga studentët e Departamentit të Kimisë;
  - 1(një) anëtar zgjidhet nga studentët e Departamentit të Matematikës dhe i Fizikës;
  - 1(një) anëtar zgjidhet nga studentët e Departamentit të Shkencave Detare;
  - 2(dy) anëtarë zgjidhen nga studentët e Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare;
8. Zgjedhjet zhvillohen me votim të lirë dhe të fshehtë sipas përcaktimeve të kësaj Rregulloreje.




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**  
**SENATI AKADEMIK**

9. Çdo student mund të vetëkandidohet për tu zgjedhur në Këshillin studentor të fakultetit në të cilën bën pjesë sipas parashikimeve të kësaj Rregullore.
10. Çdo kandidat që kandidon ka të drejtën të organizojë dhe të zhvillojë aktivitete për paraqitjen e programit të tij, duke mos cënuar procesin mësimor.
11. Shpallet i zgjedhur në pozicionin e anëtarit të këshillit studentor të fakultetit përkatës kandidati që fiton numrin më të madh të votave të vlefshme të zgjedhësve që marrin pjesë në votim, me përjashtim të kandidatit të vetëm, të cilët duhet të marrin 50%+1 të votave të vlefshme.
12. Çdo kandidat ka të drejtën të ketë vëzhguesit e tij në qendrën e votimit, qendrën e numërimit si dhe në KIZS ditën e votimit. Lista e vëzhguesve duhet të paraqitet pranë KIZS jo më vonë se 7 (shtatë) ditë para zhvillimit të zgjedhjeve. Vëzhgues mund të jetë vetëm një student me gjendje aktive pranë Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.
13. Për kandidatët që fitojnë numër të barabartë votash, zgjedhja e tyre do të bëhet me short nga Komisioni Institucional Zgjedhor Studentor (KIZSUIQV)-së, në praninë e kandidatëve.

**Neni 5**  
**Periudha zgjedhore**

1. Zgjedhjet për Këshillat studentorë në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë zhvillohen në mënyrë periodike, çdo 2(dy) vjet, në të gjithë universitetin.
2. Dita e fillimit të procesit zgjedhor dhe dita e zgjedhjeve caktohet me vendim të Rektorit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.
3. Zgjedhjet për Këshillin studentor në nivel institucional dhe për Këshillat studentoë në nivel njësie kryesore do të zhvillohen në të njëjtën ditë.
4. Qendrat e votimit hapen në orën 09:00 dhe mbyllen në orën 15:00. Askush nuk mund të votojë pasi komisionet e qendrave të votimit marrin vendim për mbylljen e votimit, pasi janë siguruar për votimin e të gjithë studentëve që janë jashtë qendrës së votimit në pritje për të votuar para orës 15.00.
5. Në momentin e nisjes së këtij procesi, duhet të vihen në dijeni autoritetet drejtuese të UV-së.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**  
**SENATI AKADEMIK**

**KREU II**

**PËRGATITJA DHE ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE**

**Neni 6**

**Komisioni Institucional Zgjedhor Studentor i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë (KIZS)**

1. Komisioni Institucional Zgjedhor Studentor i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë është organi përgjegjës për organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor për këshillat studentore të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.
2. Anëtarët e KIZS kanë mandat 2(dy)-vjeçar dhe nuk lejohen të kandidojnë për asnjë pozicion në këshillat studentore gjatë kësaj periudhe.
3. Senati Akademik me shumicë votash zgjedh anëtarët e KIZS nga studentët që janë vetëkandiduar, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e datës të zgjedhjeve. Jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas votimit nga Senati Akademik i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, KIZS duhet të konstituohet.

**Neni 7**

**Përbërja dhe funksionet e KIZS**

1. Komisioni Institucional Zgjedhor Studentor në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë përbëhet nga 5(pesë) anëtarë (1(një) përfaqësues për çdo fakultet, fakulteti që ka numrin më të lartë të studentëve do të ketë 2(dy) përfaqësues), të gjithë me të drejtë vote. Në rast se votimi del barazim vendos vota e kryetarit të KIZS.
2. Në mbledhjen e parë të tij KIZS zgjedh, me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të tij kryetarin dhe sekretarin me votim të fshehtë. Mbledhjet thirren nga kryetari ose të paktën nga 2(dy) anëtarë. Mbledhja është e vlefshme kur marrin pjesë jo më pak se 2/3 e të gjithë anëtarëve.
3. Vendimet e KIZS merren me shumicë të thjeshtë votash.
4. KIZS ka këto kompetenca:
  - a) nxjerr udhëzime për organizimin dhe zhvillimin e procesit zgjedhor;
  - b) drejton dhe kontrollon të gjithë procesin zgjedhor;
  - c) për zgjedh me short anëtarët dhe sekretarin e komisioneve zgjedhore studentore të fakulteteve të cilët vetëkandidohen pranë KIZS;
  - d) miraton vulën për KIZS-in, për KZS-ën dhe KQV-të e fakulteteve përkatëse, të cilat prodhohen dhe administrohen sipas kuadrit ligjor në fuqi;
  - e) regjistron kandidatët për anëtar të Këshillit Studentor në nivel institucional dhe në nivel njësie kryesore;
  - f) shpall rezultatin e zgjedhjeve;
  - g) administron, gjykon dhe merr vendim pr ankimet që regjistrohen prej kandidatëve.







REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
SENATI AKADEMIK

5. Mandati i anëtarit të KIZS-it ndërpritet në rastet kur:
  - a) kryen veprimtari në favor të një kandidati;
  - b) jep dorëheqjen nga detyra;
  - c) humbet statusin e studentit;
  - d) dënohet për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
  - e) me veprimet dhe mosveprimet e tij cënon rëndë veprimtarinë e komisionit dhe procesin zgjedhor;
  - f) mungon, pa shkaqe të arsyeshme, në 3(tre) mbledhje radhazi.
6. Vendi i mbetur vakant plotësohet brenda 24 orëve nga listat ekzistuese të studentëve që janë vetëkandiduar në votimin e parë.
7. Sekretari i KIZS përgatit materialet për çdo mbledhje dhe mban procesverbalin e mbledhjeve së bashku me protokollin e KIZS-it. Sekretari është përgjegjës për mbajtjen dhe administrimin e gjithë dokumentacionit të KIZS-it.
8. Procesverbali i mbledhjeve duhet të mbahet me shkrim dore nga një prej anëtarëve të KIZS dhe firmoset nga anëtarët e pranishëm në mbledhje dhe vuloset. Vendimet e KIZS-it duhet të firmosen nga të gjithë anëtarët dhe vulosen me vulën e KIZS. Në rast se një prej anëtarëve është kundër, kjo duhet të paraqitet në fund të vendimit.

### Neni 8

#### Komisioni i Apelimit Studentor (KAS)

1. KAS përbëhet nga 3(tre) anëtare, me mandat 2(dy)-vjeçar, të cilët nuk kanë të drejtë të kandidojnë për poste të tjera gjatë mandatit si anëtarë të KAS. Ky komision shërben për të ankimuar vendimet e KIZS-it.
2. Senati Akademik zgjedh KAS-in, nga studentët që janë vetëkandiduar, me shumicë votash, brenda 5(pesë) ditëve nga shpallja e datës së zgjedhjeve. Jo më vonë se 5(pesë) ditë pas votimit nga Senati Akademik KAS-i duhet të konstituohet.
3. Në mbledhjen e parë të tij KAS-i zgjedh, me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të tij, kryetarin. Mbledhjet thirren nga kryetari.
4. Vendimet KAS i merr më shumicë të thjeshtë votash.
5. KAS-i ka këto kompetenca:
  - a) shqyrton dhe merr vendim të arsyetuar, në të cilin përfshihen dhe mendimet "kundër", për çdo ankim për vendime të marra prej KIZS-it;
  - b) administron, gjykon dhe merr vendim për ankimimet që regjistrohen prej kandidatëve;
  - c) dërgon për dijeni në KIZS vendimet e marra për ankesat që janë paraqitur pranë tij.
6. Vendimi i KAS-it është i formës së prerë, përfundimtar dhe i detyrueshëm për t'u zbatuar.
7. Mandati i anëtarit të KAS-it ndërpritet në rastet kur:
  - a) kryen veprimtari në favor të një kandidati;
  - b) jep dorëheqjen nga detyra;
  - c) humbet statusin e studentit;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**  
**SENATI AKADEMIK**



- d) dënohet për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
  - e) me veprimet dhe mosveprimet e tij cënon rëndë vepritarimë e komisionit dhe procesin zgjedhor;
  - f) mungon, pa shkaqe të arsyeshme, në 3(tre) mbledhje radhazi.
8. Vendi i mbetur vakant plotësohet brënda 24 orëve nga listat ekzistuese të studentëve që janë vetëkandiduar në votimin e parë.
  9. Procesverbali i mbledhjes duhet të firmoset nga anëtarët e pranishëm në mbledhje dhe vuloset. Vendimet e komisionit firmosen prej të gjithë anëtarëve dhe vulosen me vulën e KAS. Çdo anëtar i KAS, krahas nënshkrimit mund të deklarojë votën kundër.

### Neni 9

#### Komisionet Zgjedhore Studentore (KZS)

1. Vendimi për ngritjen e KZS-ve merret jo më vonë se 5(ditë) ditë nga konstituimi i KZS-it.
2. Anëtarët e KZS-ve nuk kanë të drejtë të kandidojnë për asnjë post tjetër. Ata zgjidhen me votim të fshehtë nga KZS-ja në bazë të kërkesave për vetëkandidim të paraqitura prej studentëve.
3. KZS-ja përbëhet nga 5(pesë) anëtare, të cilët me votim të hapur zgjedhin kryetarin dhe sekretarin e KZS-së me shumicë të thjeshtë.
4. Sekretari i KZS-së përgatit materialet për çdo mbledhje dhe mban procesverbalin e mbledhjeve sëbashku me protokollin e KZS. Sekretari është përgjegjës për mbajtjen dhe administrimin e të gjithë dokumentacionit të KZS.
5. Vendimet e KZS-së duhet të firmosen nga të gjithë anëtarët. Në rast se një prej anëtarëve është kundër, mendimi kundër paraqitet në vendim.
6. KZS-të kanë këto kompetenca:
  - a) përgjigjen për administrimin dhe zhvillimin e procedurave të votimit për trupën zgjedhore të fakultetit përkatës;
  - b) pas përfundimit të procesit të votimit, marrin në dorëzim kutitë e votimit bashkë me materialet zgjedhore të KQV-vë përkatëse dhe me pas, fillonë procesin e numerimit të votave, rezultatin e të cilave e pasqyrojnë në procesverbalet përkatëse;
  - c) shpallin me vendim rezultatet e votimeve për këshillin studentor të fakultetit përkatës.
7. Mandati i anëtarit të KAS-it ndërpritet në rastet kur:
  - a) kryen veprimtari në favor të një kandidati;
  - b) jep dorëheqjen nga detyra;
  - c) humbet statusin e studentit;
  - d) dënohet për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
  - e) me veprimet dhe mosveprimet e tij cënon rëndë vepritarinë e komisionit dhe procesin zgjedhor;
  - f) mungon, pa shkaqe të arsyeshme, në 3(tre) mbledhje radhazi.
8. Vendi i mbetur vakant plotësohet brënda 24 orëve nga listat ekzistuese të studentëve që janë vetëkandiduar më parë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**  
SENATI AKADEMIK

**Neni 10**  
**Komisionet e Qendrave të Votimit (KQV)**

1. Vendimi për ngritjen e KQV-ve merret nga KZS jo më vonë se 3(tre) ditë nga konstituimi i saj, duke përcaktuar kryetarin dhe sekretarin e KQV-së.
2. Anëtarët e KQV-ve nuk kanë të drejtë të kandidojnë për asnjë post tjetër. Ata zgjidhen me votim të fshehtë në bazë të kërkesave për vetëkandidim të paraqitura prej studentëve.
3. KQV-ja përbëhet nga 3(tre) anëtarë.
4. KQV-të kanë këto kompetenca:
  - a) përgjigjen për administrimin dhe zhvillimin e procedurave të votimit për trupën zgjedhore të qendrës përkatëse;
  - b) pas përfundimit të procesit të votimit, i dërgojnë kutitë e votimit pranë KZS-së së njësisë përkatëse.

**Neni 11**  
**Shpërndarja e komisioneve të qendrave të votimit të fakulteteve**

1. Në Fakultetin e Shkencave Humane do të ketë 2 (dy) KQV.
2. Në Fakultetin e Shkencave Teknike do të ketë 2 (dy) KQV.
3. Në Fakultetin e Ekonomisë do të ketë 2 (dy) KQV.
4. Në Fakultetin e Shëndetit Publik do të ketë 2 (dy) KQV.

**Neni 12**  
**Qendrat e votimit**

1. Në të gjitha qendrat e votimit votohet për të gjithë anëtarët e këshillave studentorë të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.

**KREU III**  
**ZGJEDHËSIT DHE LISTA E ZGJFDHËSVE**

**Neni 13**  
**Zgjedhësit dhe përgatitja e listës së zgjedhësve**

1. Organi përgjegjës për hartimin e listës së zgjedhësve është sekretaria mësimore e fakultetit përkatës, duke ndarë më vetë listat sipas secilit programi të studimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
SENATI AKADEMIK

2. Procedura për hartimin e listës së zgjedhësve është si më poshtë vijon:
  - a) Lista paraprake e studentëve hartohet nga sekretaria mësimore brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga e nesërmbja e shpalljes së ditës së zgjedhjeve.
  - b) Lista paraprake afishohet në mjediset e fakulteteve përkatëse.
  - c) Gjatë një periudhe deri në 5(pesë) ditë nga shpallja e listës paraprake, sekretaria mësimore pranon kërkesat për korrigjime.
  - d) Pas verifikimit të kërkesës, sekretaria mësimore realizon korrigjimin e kërkuar brenda 24 orëve.
  - e) Pas përfundimit të afatit për korrigjimin e listës, sekretaria mësimore dërgon për miratim tek Dekani i fakultetit përkatës listën përfundimtare.
3. Lista e zgjedhësve e miratuar duhet të jetë e firmosur në çdo faqe nga Dekani, si dhe e vulosur me vulën e fakultetit përkatës.
4. Lista e zgjedhësve afishohet në mjediset e fakultetit përkatës dhe një kopje i dërgohet KIZS-it.

**KREU IV**  
**REGJISTRIMI I KANDIDATËVE PËR ANËTAR TË KËSHILLIT STUDENTOR TË**  
**FAKULTETIT DHE FUSHATA ZGJEDHORE**

**Neni 14**

**Afati i regjistrimit të kandidatëve**



1. Procesi i regjistrimit të kandidatëve për anëtarë të KSF bëhet nga KIZS. Data për fillimin e procedurës për regjistrimin e kandidatëve shpallet prej KIZS pas ditës së 7 (shtatë) të kstitutumit të tij dhe zgjat 10 (dhjetë) ditë kalendarike.
2. Dokumentet e kandidimit duhet të jenë në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

**Neni 15**

**Dokumentacioni për kandidim**

1. Dokumentacioni për kandidim nga kandidatët dorëzohet në KIZS dhe përmban:
  - a) Kërkesën për aplikim e cila përfshin: emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen, gjininë dhe shprehjen e vullnetit për kandidim për anëtarë të KSF;<sup>1</sup>
  - b) fotokopjen e dokumentit të identifikimit;
  - c) vërtetimin që provon se është student pranë fakultetit përkatës;
2. Pas verifikimit të dokumentacionit, KIZS-ja, jo më vonë se 24 (njëzetekatër) orë nga përfundimi i afatit të paraqitjes së kërkesave për kandidim, miraton listat e kandidatëve,

<sup>1</sup> Modeli i punuar i formularit të aplikimit gjendet bashkëlidhur shkresës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**  
SENATI AKADEMIK

për anëtarë të KSF, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje. Listat përfundimtare përcillen në komisionet zgjedhore studentore të fakulteteve dhe shpallen publikisht në mjediset e fakultetit përkatës dhe në faqen zyrtare në internet.

**Neni 16**  
**Kohëzgjatja e mandateve**

1. Anëtarët e Këshillit Studentor të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë si dhe anëtarët këshillave studentorë të njësisë bazë zgjidhen për një mandat 2-vjeçar.

**Neni 17**  
**Fushata zgjedhore**

1. Fushata zgjedhore fillon një ditë pas shpalljes së kandidatëve të regjistruar.
2. Fushata zgjedhore përfundon 24 orë para ditës së zgjedhjes. Data para datës së zgjedhjeve dhe data e zgjedhjeve deri në mbylljen e votimit formojnë periudhën e heshtjes zgjedhore. Në periudhën e heshtjes zgjedhore nuk lejohet asnjë lloj fushate zgjedhore.
3. Në përputhje me kërkesën e kandidatëve për kohën dhe vendin e zhvillimit të aktiviteteve, Administratori dhe dekanët e fakulteteve dhe administrata e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë merr të gjitha masat e nevojshme për zhvillimin e tij, pa cënuar procesin mësimor si dhe përcakton mjediset dhe plotëson kërkesat e komisioneve të ngritura në fakultetin përkatës me qëllim zhvillimin e zgjedhjeve.


**KREUV**  
**PËRGATITJA E INFRASTRUKTURËS DHE E DOKUMENTACIONIT PËR**  
**ZGJEDHJET**



**Neni 18**  
**Vendndodhja e komisioneve zgjedhore dhe vendeve të numërimit të votimeve**

1. Vendndodhja e komisioneve zgjedhore përcaktohet sipas rregullit të mëposhtëm:
  - a) Selia e KIZS-it dhe KAS-it vendoset në godinën e Rektotatit të UV-së.
  - b) Selitë e KZS-ve dhe KQV-ve vendosen në godinat përkatëse të fakulteteve të UV-së, të cilat shërbejnë edhe si vende të votimit dhe numërimit të votave.

**Neni 19**  
**Komisionet për vlerësimin dhe numërimin e votave**

1. Votat vlerësohen dhe numërohen prej KZS-ve të fakulteteve përkatëse.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**  
SENATI AKADEMIK

2. KZS-të e fakulteteve përkatëse të UV-së, pas numërimit të votave, plotësojnë tabelën zgjedhore dhe ia përcjellin atë KIZS-së.
3. KIZS-ja shpall rezultatet e zgjedhjeve sipas përcaktimeve në këtë rregullore dhe pas kalimit të afateve për ankimimin, shpall fituesit e zgjedhjeve.

### Neni 20

#### Përgatitja e dokumentacionit zgjedhor

1. Sasia e fletëve të votimit është barabartë me numrin e zgjedhësve sipas listave përkatëse, plus 1% e tyre.
2. Forma e fletës së votimit përgatitet prej KIZS-së.
3. Fletët për anëtarë të këshillit studentor të fakultetit përkatës të UV-së kanë ngjyra të ndryshme nga fleta e votimit për çdo fakultet.
4. Fleta duhet të jetë me specifika të tilla që të mos lejojnë manipulimin e tyre, prej letre format A4, me ngjyrë dhe trashësi që të mos lejojë leximin e votës në pjesën e pasme të saj.
5. Fletët e votimit përmbajnë informacionet e mëposhtme:
  - a) Në to vendosen emrat e kandidatëve për anëtarë të këshillit studentor të njësisë bazë të UV-së.
  - b) Të gjitha fletët e votimit vulosen me vulën e KIZS-së përpara se të dërgohen në KZS-të e njësisë bazë.

### Neni 21

#### Dërgimi i materialeve zgjedhore nga KIZS-ja në KZS-të e fakulteteve të UV-së

1. Një ditë përpara datës së zgjedhjeve, KIZS-ja dërgon në KZS-të e fakulteteve të UV-së kutitë me materialet zgjedhore, si më poshtë vijon:
  - a) Fletët e votimit të vulosura me vulën e KIZS-it në përputhje me numrin e votuesve +1%;
  - b) Listën e zgjedhësve;
  - c) Vulën e KZS-it dhe vulat e KQV-ve të secilit fakultet;
  - d) Procesverbalet e qendrës së votimit, ku bëjnë pjesë procesverbalet për vulosjen e kutive të votimit, hapjen e qendrës së votimit, si dhe mbylljen e votimit;
  - e) Zarfën me të cilin është shënuar "Fletë votimi të dëmtuara";
  - f) Zarfën në të cilin është shënuar "Fletë votimi të papërdorura";
  - g) Zarfën në të cilin është shënuar "Zarfë i procesverbalit të vulosjes";
2. Përveç kutisë me materiale zgjedhore, në KZS dërgohen edhe kutitë e votimit, tabelat për rezultatin e zgjedhjeve, dhomat e fshehta dhe vulat me kodet e sigurisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
SENATI AKADEMIK

3. KZS-ja shpërndan bazën materiale të nevojshme për zhvillimin e votimit në KQV-të e ngritura në fakultetin përkatës. Ky proces bëhet ditën e zgjedhjeve, përpara fillimit të procesit të votimit, si dhe pasqyrohet në procesverbalin përkatës.

## KREU VI VOTIMI

### Neni 22

#### Veprimet paraprake për hapjen e qendrës së votimit

1. Në çdo qendër votimi votohet në një kuti votimi, kutia e votimit për anëtarët e këshillit studentor përkatës të UV-së, të cilat janë të dallueshme nga njëra-tjetra.
2. KZS-të dhe KQV-të, nën drejtimin e kryetarit, një orë përpara hapjes së qendrës së votimit, kryejnë këto detyra:
  - a) Vendosin tryezat, karriget, dhomat e fshehta dhe kutitë e votimit, në mënyrë të tillë që të sigurohet fshehtësia e votimit, si edhe lëvizja e shpejtë dhe e lirshme e zgjedhësve;
  - b) Afishojnë udhëzimet për kryerjen e votimit në një vend të përshtatshëm dhe të dukshëm brenda qendrës së votimit;
  - c) Kontrollonjë të gjitha materialet e marra në dorëzim;
  - d) U tregojnë të pranishmëve kutitë e votimit të zbrazëta;
  - e) Mbyllin kutitë e votimit dhe i shkruajnë këto kode në procesverbain e vulosjes së kutive të votimit dhe në librin e protokollit të mbledhjeve, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e KQV-së.
3. Procesverbali mbyllet në zarfën ku është shkruar "Zarfë i procesverbalit të vulosjes", i cili futet në kutinë e votimit. Anëtarët e KZS-ve dhe KQV-ve marrin vendimi për hapjen e votimit dhe e nënshkruajnë atë.

### Neni 23

#### Procedurat e votimit

1. Votimi për anëtarë të këshillit studentor të fakultetit bëhet në të njëjtën ditë, në datën e caktuar nga dekani i fakultetit përkatës të UV-së. Pas kryerjes së detyrave të përcaktuara në këtë rregullore, kryetari i KZS-it dhe KQV-së deklaron hapjen e votimit, por jo më vonë se ora 09:00.
2. Fletët e votimit janë të vulosuar në pjesën e pasme, në vendin e caktuar, me vulën e KZS-it. Zgjedhësit qëndrojnë në rradhë jashtë qendrës së votimit dhe futen njëri pas tjetrit në qendrën e votimit për të votuar, me thirrjen e një anëtarë të komisionit. Pasi zgjedhësi hyn në qendrën e votimit:




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
SENATI AKADEMIK

- a) Thotë emrin e tij dhe paraqet para komisionit një nga dokumentet zyrtare të identifikimit:
    - Letërnjoftim ID;
    - Pasaportë.
  - b) Kryetari, pasi verifikon se të dhënat e indentitetit të zgjedhësit përputhen me të dhënat në listën e zgjedhësve, llojin dhe numrin e serisë së dokumentit të identitetit dhe i heq vizë emrit të zgjedhësit në këtë listë;
  - c) Nënshkruan në listën e zgjedhësve anash emrin e tij;
  - d) Kryetari vulos fletën e votimit me vulën e KZS-së/KQV-së dhe ia jep zgjedhësit;
  - e) Pasi merr fletën e votimit, zgjedhësi hyn në dhomën e fshehtë dhe në krah të emrit të kandidatit shënon "X" ose "+", ose çdo shenjë tjetër brenda kuadrit të përcaktuar për shënim nga ana e zgjedhësit;
  - f) Pasi bën shënimin në fletën e votimit, zgjedhësit palos fletët në mënyrë që shenja të mos jetë e dukshme, del nga dhoma e fshehtë, e hedh fletën në kutinë përkatëse të votimit dhe largohet nga qendra e votimit.
3. Qendra e votimit organizohet në një mënyrë të tillë që të lehtësojë procesin e votimit dhe të garantojë plotësisht fshehtësinë e votës.
  4. Në qendrën e votimit është i ndaluar përdorimi i mjeteve të komunikimit apo regjistrimit nga ana e votuesit.
  5. Në qendrën e votimit mund të qëndrojnë vetëm:
    - a) Anëtarët e KZS-ve ose KQV-vedhe vëzhguesit e miratuar nga KIZS-ja për llogari të kandidatëve;
    - b) Zgjedhësit që janë duke kryer procedurat e votimit, deri në përfundim të tyre.

**Neni 24**  
**Mbyllja e votimit**

1. Qendrat e votimit mbyllen në orën 15:00. Nëse edhe pas kalimit të këtij orari ka zgjedhës që presin në radhë, komisioni mbledh dokumentet e identifikimit të të gjithë zgjedhësve të pranishëm dhe i thërret ata me radhë për të kryer votimin.
2. Asnjë zgjedhës nuk do të lejohet të votojë nëse nuk ka qenë në radhë në kohën e mbledhjes së dokumentit të identifikimit. Pasi voton edhe zgjedhësi i fundit i pranishëm, komisioni merr vendim për mbylljen e votimit, duke plotësuar formularin përkatës, ku shënohet edhe ora e mbylljes së votimit. Pas kësaj, në qendrën e votimit mund të qëndrojnë vetëm anëtarët e komisionit.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE**  
SENATI AKADEMIK

**Neni 25**


**Veprimet pas mbylljes së qendrës së votimit**


1. Pas marrjes së vendimit për mbylljen e votimit, kryetari, në praninë e anëtarëve të komisionit kryen, siaps radhës, veprimet e mëposhtme:
  - a) Shënon numrin e zgjedhësve, që kanë votuar, duke numëruar nënshkrimet e bëra në listën përkatëse të zgjedhësve, të cilët kanë votuar sipas kushteve të parashikuara në këtë rregullore.
  - b) U deklaron shifrat me zë të lartë anëtarëve të tjerët të komisionit;
  - c) I fton ata të verifikojnë shifrat e thëna prej tij.
2. Në rast kundërshtimesh për përcaktimin e shifrës, pretendimet shënohen në procesverbal.
3. Kryetari, nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve të komisionit, i numëron fletët e votimit të dëmtuara që gjenden në zarfin "Fletëvotimi të dëmtuara" për secilën kategori. Numri i fletëve të votimit të dëmtuara pasqyrohet në procesverbalin për "Mbylljen e votimit".
4. Kryetari, nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve të komisionit, numëron edhe fletët e papërdorura dhe i vendos ato në zarfin përkatës. Numri i fletëve të votimit të papërdorura pasqyrohet në procesverbalin për "Mbylljen e votimit".
5. Kryetari i KQV-së, bashkë me anëtarët e tjerë të komisionit, dorëzojnë në KZS-në e fakultetit përkatës kutitë e votimit bashkë me materialet zgjedhore të qendrës së votimit.
6. Procesi vijues i vlerësimit, numërimit dhe nxjerrjes së rezultatit për zgjedhjet e këshillit studentor të fakultetit kryhet nga KZS-të përkatëse dhe vazhdon pa ndërprerje deri në nxjerrjen e rezultatit përfundimtar për fakultetin përkatës.

**Neni 26**

**Vlerësimi, numërimi i votave dhe nxjerrja e rezultatit për zgjedhjet e këshillave studentore të fakulteteve të UV-së**

1. Procesi i vlerësimit, numërimit dhe nxjerrjes së rezultatit për zgjedhjet e këshillit studentor të fakultetit kryhet nga KZS-të përkatëse dhe vazhdon pa ndërprerje deri në nxjerrjen e rezultatit përfundimtar për fakultetin përkatës.
2. Kryetari i KZS-së nxjerr nga kutia e votimit fletët e votimit, i shpalos dhe i vendos mbi tryezë, me pjesën e pasme të fletës nga ana e sipërme. Pas kësaj ai:
  - a) vlerëson të gjitha votat e gjetura në kuti, duke ia treguar të gjithë anëtarëve të KZS-së. Votat e pavlefshme ndahen në një grup të veçantë;
  - b) numëron votat e vlefshme dhe të pavlefshme. Numri i tyre, sëbashku me numrin e përgjithshëm të votave të gjetura në kuti shënohen në procesverbal;
  - c) verifikon numrin e përgjithshëm të votave të gjetura në kuti me numrin e votave që duhet të gjenden në kuti, në bazë të të dhënave të procesverbalit të hartuar më parë të KQV-ve ose KZS-së përkatëse, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje, për numrin e përgjithshëm të fletëve të votimit, fletëve të votimit të papërdorura dhe fletëve të votimit të dëmtuara. Rezultati shënohet në procesverbal.






REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE**  
**SENATI AKADEMIK**

- d) harton tabelën përfundimtare për kutinë përkatëse dhe e miraton me vendim.
3. Pas përfundimit të vlerësimit dhe numërimit të votave, KZS-ja harton tabelën përfundimtare të rezultatit të votimit sipas numrit të votave.
  4. Tabela përfundimtare dhe vendimi përkatës i KZS-së, si dhe të gjitha procesverbalet e tjera nënshkruhen nga të gjithë anëtarët dhe kryetari, duke deklaruar votën "pro" ose "kundër".
  5. Kopjo e tabelës përfundimtare të rezultatit të votimit u jepet, sipas kërkesës, kandidatëve.
  6. Çdo kontestim apo vëretje e kandidatëve shënohet detyrimisht në procesverbal nga sekretari i KZS-së.
  7. Në përfundim të procesit të vlerësimit dhe numërimit të votave, në prani të KZS-së dhe/ose kandidatëve të pranishëm:
    - a) Futet dhe administrohen në kutinë e votimit fletët e votimit të numëruara të vlefshme dhe të pavlefshme;
    - b) Futet dhe administrohet në kutinë e materialeve zgjedhore zarfi "Fletë votimi të papërdorura";
    - c) Futet dhe administrohet në kutinë e materialeve zgjedhore "Fletëvotimi të dëmtuara";
    - d) Futet dhe administrohet në kutinë e materialeve zgjedhore procesverbali për numrin e fletëve të votimit gjithsej, numrin e fletëve të papërdorura dhe numrin e fletëve të dëmtuara, si dhe tabela përfundimtare të rezultatit të votimit për KZS-në përkatëse.
  8. Kryetari i KZS-së mbyll kutitë e votimit dhe shënon në procesverbal elementët e sigurisë (kodet) për mbylljen e këtyre kutive.
  9. Dorëzimi i materialeve zgjedhore dhe i kutive të votimit në KIZS bëhet nga kryetari i KZS-it me procesverbal, në prani të anëtarëve të KZS-së përkatëse dhe/ose kandidatëve, menjëherë pas përfundimit të proceseve të përshkruara në këtë rregullore.


**Neni 27**

**Shpallja e rezultatit paraprak të zgjedhjeve për Këshillin Studentor të UV-së**

1. Pas përfundimit të vlerësimit dhe numërimit të votave, nxjerrjes së rezultatit të votimit nga të gjithë KZS-të dhe dërgimin e tyre në KIZS, ky i fundit, brenda 24 orrëve, harton tabelën e rezultateve të votimit dhe shpall me vendim të veçantë, rezultatet e zgjedhjeve për anëtarët dhe kryetarin e këshillit studentor të fakultetit përkatës të UV-së.
2. Tabela e rezultateve zgjedhore dhe vendimi i KIZS-it nënshkruhen nga të gjithë anëtarët.
3. Kopje e tabelës përfundimtare të rezultatit të zgjedhjeve u jepet, sipas kërkesës, kandidatëve.








REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**  
SENATI AKADEMIK

**Neni 28**  
**Ankimimi**

1. Kundër vendimeve të KIZS-it për shpalljen e tabelave përfundimtare të rezultatit të zgjedhjeve, ankimimi bëhet nga kandidatët në KIZS jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendarike nga data e shpalljes së tyre. Për efekt të llogaritjes së afatit, periudha 2- ditore fillon në orën 16:00, pas dy ditëve kalendarike. KIZS-ja administron dhe merr vendime për ankimimet jo më vonë se 48 orë pas paraqitjes së tyre.
2. Kundër vendimeve të KIZS-it për ankesat e kandidatëve për rezultatin e zgjedhjeve, apelimi i vendimit bëhet nga kandidatët në komisionin e Apelimit Studentor (KAS) jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendarike nga data e marrjes së vendimit. Për efekt të llogaritjes së afatit, periudha 2- ditore fillon në orën 16:00 të ditës së shpalljes së aktit për të cilin bëhet ankimimi dhe përfundon në orën 16:00, pas 2 (dy) ditëve kalendarike.
3. Me përfundimin e procesit të shqyrtimit të ankimimeve të dërguara nga Komisioni i Apelimit Studentor, KIZS-ja shpall, me vendim të veçantë, rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve. Data e thirrjes së mbledhjes së parë të këshillave studentorë të fakulteteve të UV-së caktohet nga kryetari i KIZS-it. Kjo datë shënon fillimin e punës së këshillit studentor të fakultetit.

**Neni 29**  
**Zgjedhja e kryetarit të Këshillit Studentor të UV-së dhe Fakultetit**

1. Pas përfundimit të afateve të apelimit, organizohet mbledhja e parë e këshillit studentor të UV-së, e cila thirret nga KIZS-ja jo më vonë se dy javë nga ky afat. Në këtë mbledhje marrin pjesë të gjithë anëtarët e këshillave studentore të fakulteteve të UV-së, të shpallur fitues nga zgjedhjet e zhvilluara. Në këtë mbledhje bëhet kostituimi dhe, më pas, caktohet data e mbledhjes së dytë në të cilën zgjidhet kryetari i KSUIQV-së. Në këtë mbledhje, ata, bashkë me të gjithë anëtarët e këshillave studentorë të fakulteteve të UV-së, zgjedhin mes tyre e votim të fshehtë kryetarin e Këshillit Studentor të UV-së. Mandati i kryetarit të KSUIQV-së është 2 vjeçar.
2. Anëtari i këshillit studentor të fakultetit, i zgjedhur në postin e kryetarit të Këshillit Studentor të UV-së, mban dhe postin e mëparshëm.
3. Sekretari i këshillit studentor të UV/ Fakultetit, zgjidhet një nga anëtarët e këshillit përkatës, i cili vetëkandidohet ose propozohet nga anëtarët e këshillave studentorë të fakulteteve të UV-së. Mandati i sekretarit është 2- vjeçar.
4. E njëjta procedurë zbatohet edhe përzgjedhjen e Kryetarit të Këshillit Studentor të Fakulteteve.
5. Selia ku do të bëhet mbledhja e këshillit Studentor të UV caktohet nga Rektori, ndërsa e fakulteteve vendoset nga Dekani jo më vonë se 2 ditë pasi është caktuar data e mbledhjes së parë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
SENATI AKADEMIK

**Neni 30**  
**Pavlefshmëria e zgjedhjeve**

1. KIZS-ja kryesisht ose me kërkesë të kandidatëve, i shpall zgjedhjet e pavlefshme në një ose më shumë qendra votimi, në rast se:
  - a) Kanë ndodhur shkelje të ligjt;
  - b) Mund të jetë cënuar procesi zgjedhor në një masë të tillë që mund të ketë ndikuar në fitimin e mandateve;
  - c) Kanë ndodhur fatkeqësi natyrore në përmasa të tilla që kanë penguar pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim.
2. Kërkesën për pavlefshmëri të zgjedhjeve kërkuesi duhet ta shoqërojë me shpjegimin për arsyet ligjore ku mbështetet kërkesa, përshkrimin e shkeljeve të pretenduara dhe arsyetimin e detajuar të tyre për pasojat që kanë prodhuar. Shqyrtimi i kërkesës për pavlefshmëri të zgjedhjeve dhe vendimmarrja për kërkesën bëhet nga KIZS-ja, por jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendarike nga depozitimi i saj.

**Neni 31**  
**Dispozita të fundit**

1. I gjithë dokumentacioni zgjedhor ruhet në arkivën e KSUIQV-së, në bazë të rregullave të përcaktuara në kuadrin ligjor për administrimin, ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit.
2. Në rast të mbarimit të përkohshëm të mandatit të kryetarit ose anëtarëve të KSUIQV-së apo këshillave studentorë të fakulteteve të UV-së, ata zëvendësohen nga kandidatët pasardhës në renditje për nga numri i votave të grumbulluara në zgjedhje, deri në përfundim të mandatit të nisur.
3. Të drejtën e interpretimit të kësaj rregulloreje e ka Komisioni Institucional Zgjedhor i UV-së, i cili mund të ofrojë mbështetje përgjatë gjithë procesit zgjedhor.
4. Të gjitha shpenzimet për procesin zgjedhor për Këshillin Studentor të UV-së do të mbulohen nga buxheti i UV-së.
5. Kjo rregullore është e detyrueshme për t'u zbatuar si e tillë nga të gjitha strukturat studentore të UV-së dhe hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**  
**Prof.Dr. Aurela SALIAJ**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
SENATI AKADEMIK

FORMULAR APLIKIMI PËR ANËTAR TË KËSHILLIT STUDENTOR

**TË DHËNA PERSONALE:**

Emri \_\_\_\_\_; Atësia: \_\_\_\_\_;

Mbiemri: \_\_\_\_\_;

Datëlindja (dd/mm/VVVV): \_\_\_\_\_ / \_\_\_\_\_ / \_\_\_\_\_;

Vendlindja: \_\_\_\_\_;

Gjinia: Femër Mashkull

Adresa e e-mail-it: \_\_\_\_\_;

Numri I telefonit të studentit: \_\_\_\_\_;

**TË DHËNA STUDENTORE:**

Fakulteti: \_\_\_\_\_

Cikli i Studimit: \_\_\_\_\_

Programi i Studimit: \_\_\_\_\_

Viti: \_\_\_\_\_

**KËRKESË PËR KANDIDIM DHE POZICIONI I KËRKUAR:**

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

FIRMA: \_\_\_\_\_